**V E N D I M**
**Nr.151, datë 5.4.1994**

**PËR VENDOSJEN E GARANCISË PËR TRANZITIN E BRENDSHËM TË MALLRAVE**

Në mbështetje të nenit 50 të ligjit nr.7599, datë 2.9.1992 "Për kodin doganor të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Garancia në doganë është depozitimi pranë organeve doganore i një shume apo i një akti me anë të të cilave sigurohet buxheti i shtetit për arkëtimin e detyrimeve doganore në rast të mosparaqitjes së mallit në doganën e destinacionit.

2. Tranzitimi i brendshëm i mallrave në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë lejohet vetëm pasi të jetë bërë më parë depozitimi i garancisë në doganë.

3. Shuma e garancisë duhet të jetë e barabartë ose më e madhe se detyrimet doganore që duhet të paguhen në qoftë se këto mallra do të futen për konsum brenda vendit.

4. Garantët janë personat fizikë ose juridikë të cilët nënshkruajnë aktin e garancisë për tranzitin e brendshëm të mallrave dhe kanë detyrimin ligjor për pagesën e gjithë detyrimeve doganore që rrjedhin nga ky akt i nënshkruar prej tyre apo personave të tretë të autorizuar prej tyre, në rast të mosparaqitjes së mallit në destinacion.

5. Format e garancisë janë:

A. Garancia personale ose me para në dorë.

Në këtë rast, për lejimin e tranzitit të brendshëm të mallrave subjekti kryen pagesën reale të shumës së caktuar nga organet doganore si garanci.

B. Garancia me anë të agjentit doganor.

Kur akti i garancisë në deklaratën e tranzitit të brendshëm të mallrave nënshkruhet nga agjenti doganor, i cili është miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave apo persona të tretë të autorizuar prej tij, përgjegjës për shlyerjen e detyrimeve doganore deri në paraqitjen e mallit në doganën e destinacionit është agjenti doganor.

C. Garancia me anë të instituteve dhe shoqërive të sigurimit.

Kur akti i garancisë në deklaratën e tranzitit të brendshëm të mallrave nënshkruhet nga institutet, shoqëritë e sigurimit ose persona të tretë të autorizuar prej tyre, përgjegjës për shlyerjen e detyrimeve doganore deri në paraqitjen e mallit në doganën e destinacionit është instituti apo shoqëria e sigurimit.

Lejohet kryerja e aktit të garancisë nga institutet apo shoqëritë e huaja të sigurimit vetëm kur ato kanë degë të tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë.

D. Garancia bankare.

Kur akti i garancisë në deklaratën e tranzitit të brendshëm të mallrave nënshkruhet nga banka ose persona të tretë të autorizuar prej saj, përgjegjës për shlyerjen e detyrimeve doganore deri në paraqitjen e mallit në doganën e destinacionit është banka.

Lejohet kryerja e aktit të garancisë nga banka të huaja vetëm kur ato kanë degë të tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë.

6. Garancia mund të bëhet veças për çdo parti malli ose globale në përputhje me pikën 4 të këtij vendimi.

Kur garanti kërkon të mbulojë globalisht detyrimet doganore për të gjithë sasinë e mallrave që do të importojë, eksportojë apo tranzitojë për një periudhë të caktuar kohe duhet të depozitojë një garanci globale pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

Shuma e kësaj garancie përcaktohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganeve dhe për llogari të saj garanti duhet ta bllokojë këtë shumë në llogarinë e tij bankare ose të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave sipas legjislacionit bankar në fuqi të shoqëruar me dokumentacionin përkatës.

7. Në zbatim të këtij vendimi, Ministria e Financave ngarkohet të nxjerrë udhëzimin përkatës në lidhje me format dhe mënyrat e kryerjes së garancisë si dhe dokumentacionin përkatës.

8. Aktet nënligjore dhe dispozitat që bien në kundërshtim me këtë vendim shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas datës së miratimit të tij.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
**Aleksandër Meksi**